



VENDIM

Nr. 45 Datë 10.05.2011

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVË PËR MODIFIKIMIN E LICENSËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË
“FAVINA” 1 SH.P.K ME SERI PV05V, NR.29, LËSHUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.116,
DATË 28.12.2010**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pika “3” dhe neneve 12 dhe 15 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, nenit 18 pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin nr.21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.05.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k, për modifikimin e licensës Nr.29, Seria PV05P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 28.12.2010, si dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma “a”** (Informacion me shkrim ku të shpegohen arsyet e kërkeses për modifikimin e licenses), **është dhënë në mënyrë të detajuar.**
- **Neni 15, pika 4, gërma “b”** (Vendim me shkrim i organeve drejtuese të të licensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licenses) **është dhënë konform rregullores.**



Pë gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për modifikimin e licenses Nr.29, Seria PV05P, të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k, për kryerjen e aktivitetit prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC Vithkuq.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.